

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5396
E mërkurë, 7 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Limaj ofron përkrahjen e Qeverisë për FSK-në

FAÇE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE

**PSE KAO NGADALË
INTEGRIMI I
KOSOVËS NË BE** F.11



Nga Mimoza KELMENDI

**PROJEKTILIGJI PËR
INSPEKTORATIN E ARSIMIT
DËRGOHET NË KUVEND** F.7

**KRYEPARLAMENTARI VESELI,
VIZITË ZYRTARE NË KROACI** F.7

EKONOMI

**GJERMANIA NDIHMON
AUV-NË PËR PLOTËSIMIN
E STANDARDEVE USHQIMORE
TË BE-së** F.9

**HAMZA INTERESOHET PËR
PËRVOJËN E SLOVENISË NË
REFORMËN E TVSH-së** F.9

KULTURË

**THEMELOHET INSPEKTORATI
I TRASHËGIMISË KULTURORE
TË KOSOVËS** F.18

SPORT

**'FINAL 8' I KUPËS,
SIVJET MË I VEÇANTË** F.18

**KOMUNA E PRISHTINËS
CAKTON LOKACIONET
POTENCIALE PËR FUSHA** F.18



**KRYETARI I KOMUNËS SË SKENDERAJT, BEKIM
JASHARI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA**

FAÇE 3

Jashari: Po përpiqen të më bllokojnë

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka kritikuar të martën asamblistët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës Kosova e Re (AKR) dhe Lëvizjes Vetëvendosje për përpjekje të bllokimit të punës së tij si kryetar i komunës. Ai ka bërë me dije se këtë po e

bëjnë duke i braktisur mbledhjet e Kuvendit Komunal. Jashari ka thënë se këto veprime nga asamblistët po bëhen për interesa të ngushta të disa individëve. Sipas të parit të Skenderajt, prapa këtyre tentimeve për bllokim qëndron kryetari i Degës së PDK-së, Sami Lushtaku

**BASHKIMI EVROPIAN (BE) KA PUBLIKUAR STRATEGJINË E ZGJERIMIT PËR VENDET
E BALLKANIT PERËNDIMOR** ■ FAÇE 4-5

BE-ja hap dyert për anëtarësim dhe kërkon plotësimin e kriterëve

Bashkimi Evropian ka prezantuar të martën strategjinë e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, me ç'rast është konfirmuar e ardhmja e tyre në një Evropë stabile, të fortë dhe të bashkuar. BE-ja ka kërkuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor përpjekje të qëndrueshme dhe reforma të pakthyeshme. Strategjia e re ka parashikuar afate kohore vetëm për Serbinë dhe Malin e Zi, sipas së cilës, këto dy vende mund të anëtarësohen në BE diku në vitin 2025. Vendet e tjera si Shqipëria, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova janë përfshirë në strategjinë e zgjerimit, por pa ndonjë afat kohor për anëtarësim



Kurti: Qeveria po pengon hetimin ndërkombëtar për Astrit Deharin

FAÇE 7

RENOVA
Maqedoni
Xhëgjajt-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob: +377(0) 44 506 815
Toll-Free: +381(0) 29 246 810
e-mail: vat_styro@satstyro.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama: Nuk kemi pretendime territoriale ndaj Greqisë

Në lidhje me atë se çfarë saktësisht kërkon Tirana për çështjen çame, kryeministri Edi Rama ka thënë se nga pala greke kjo çështje perceptohet si dëshmi e një agjende të fshehtë nga ana jonë për krijimin e Shqipërisë së madhe, por se një pretendim i tillë territorial nuk ekziston



TRANË, 6 SHKURT - Kryeministri shqiptar, Edi Rama, ka deklaruar se Shqipëria dhe Greqia ndodhen aktualisht në stadin e përmirësimit të ndjeshëm të marrëdhënieve dypalëshe. "Jam i bindur se gjithë puna e madhe që kemi bërë dhe që do të nevojitet të bëhet, do të japë fryte dhe do të na bëjë të gjithëve krenarë", ka theksuar Rama në një intervistë për të përditshmen greke "Ta Nea". I pyetur se çfarë saktësisht kërkon Tirana për çështjen çame, kryeministri shqiptar ka dhënë një përgjigje të gjatë. "Nga pala greke kjo çështje perceptohet si dëshmi e një agjende të fshehtë nga ana jonë për krijimin e Shqipërisë së madhe. Dua të jem i qartë se një pretendim i tillë territorial nuk ekziston. Një çështje terriore midis Shqipërisë dhe Greqisë nuk mund të qëndrojë. Sa na përket neve këtu në Shqipëri, çështja çame konsiston vetëm si një çështje

të drejtash themelore të bashkatdhetarëve tanë që dikur jetonin në vendin tuaj. Sinqerisht, nuk besoj se çdo njeri i arsyeshëm do ta kundërshtonte tezën se këta njerëz kanë të drejtën ta vizitojnë Greqinë apo se këta apo fëmijët e tyre duhet të kenë mundësinë që të pretendojnë të drejtat e pronës në rrugë gjyqësore, ashtu siç mundet normalisht çdo qytetar evropian. A mund të imagjinoi sot, në Evropën e shekullit 21, se burra e gra të moshuara nga Shqipëria ndalohen të futen në territorin e Greqisë fqinje ngaqë prënjët e tyre ndodhen diku në një zonë të vendit tuaj?", ka thënë Rama. Më tej kryeministri Rama i referohet mbajtjes në fuqi të Ligjit të gjendjes së luftës, që e quan absurditet. "Një fantazmë e gjallë e të kaluarës që vërtitet ndërmjet nesh dhe që pasojat juridike krijojnë pengesa të pakalueshme për

qytetarët që përmenda më sipër, por edhe për shumë të tjerë", tha ai. Rama nënvizon se negociatat në vitet e fundit ndërmjet Tiranës dhe Athinës nuk kanë qenë të lehta. "Patëm tensionet dhe fërkimet tona, megjithatë problemet i trajtuam me sinqeritet nga të dyja palët", tha ai. Rrjedhojë e këtyre përpjekjeve duket se do të jetë arritja e marrëveshjes për kufirin detar. "Jam shumë i bindur që pas pajtimit për t'u ulur bashkë në tavolinë e diskutuar me mendje e zemër të hapur, jo vetëm mund të zgjidhim çdo keqkuptim dhe paranojë të së kaluarës, por mund t'i gjejmë zgjidhjet më të mira për të ardhmen tonë të përbashkët. Dhe po, jemi afër arritjes së marrëveshjes për kufirin detar, që do të jetë e drejtë edhe për Shqipërimë, edhe për Greqinë", ka deklaruar kryeministri Edi Rama në intervistën dhënë gazetës greke "Ta Nea".

LAJME SHKURT

Meta: Dokumenti i BE-së të lexohet me vëmendje nga faktorët politikë

TRANË, 6 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, priti në një takim ambasadorën e Delegacionit të BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin.



Ambasadorja Vlahutin i dorëzoi presidentit Meta Strategjinë e re të Komisionit Evropian, "një perspektivë e besueshme zgjerimi dhe një angazhim i thelluar i BE-së në Ballkanin Perëndimor, si dhe planin e veprimit në mbështetje të transformimit të Ballkanit Perëndimor", tha Meta. Presidenti Meta vlerësoi synimin për të pasur një angazhim gjithnjë e më të madh si nga vendet e rajonit, po ashtu edhe nga Bashkimi Evropian në proceset transformuese drejt anëtarësimit të plotë të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Presidenti Meta nënvizoi se Strategjia e re e Komisionit Evropian është një dokument që duhet të lexohet me vëmendje nga faktorët politikë shqiptarë për t'u pasqyruar në përpjekjet dhe angazhimet e tyre drejt synimit të përbashkët të integritetit të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Bushati takon homologun lituanez, merr mbështetje për negociatat

TRANË, 6 SHKURT - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, në kuadër të një turit rajonal në vendet baltike, po zhvillon një vizitë në Lituanë.



Gjatë takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Lituanisë, Linas Linkevičius, ministri Bushati diskutoi për bashkëpunimin mes dy vendeve dhe për rëndësinë e gjallërimit të bashkëpunimit ekonomik. Ministrat i kushtuan vëmendje të veçantë procesit të integritetit evropian, impaktit transformues që ka politika e zgjerimit në vendet e rajonit të Ballkanit, përfshirë sigurinë e tij. Ministri Bushati e njohu kolegun e tij me procesin e reformave në Shqipëri, me fokus reformën në drejtësi, dhe masat e marra nga Qeveria shqiptare për plotësimin e pesë prioritetëve kryesorë në procesin e integritetit, me fokus hapjen e negociatave për anëtarësim. Ministri Linkevičius konfirmoi qëndrimin mbështetës të Lituanisë për një vendim pozitiv për hapjen e negociatave për anëtarësim të BE-së me Shqipërinë gjatë këtij viti.

Gashi e Majko, homazhe te varrezat e vëllezërve Bytyqi në ShBA

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, i shoqëruar nga ministri i Diasporës i Shqipërisë, Pandeli Majko, kanë takuar ish-pjesëtarët e batalionit "Atlantiku", në hotelin prej nga ku ky batalion ishte nisur për të luftuar krah për krah bashkëkombësve në radhët e UÇK-së.

Gashi dhe Majko kanë biseduar me ish-pjesëtarët e "Atlantikut" për zhvillimet në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe për tema që e shqetësojnë diasporën shqiptare në ShBA. Më pas, ata së bashku me prindërit e vëllezërve Bytyqi janë nisur për te varrezat, për ta nderuar veprën dhe sakrificën e tyre me homazhe

shtetërore dhe me vendosje të kurorës me lule. Babai i tre vëllezërve Bytyqi, Ahmet Bytyqi, ka falënderuar dy ministrat për vizitën dhe për nderimin e veprës së bijve të tij. Ndërsa ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë se vepra e tre vëllezërve Bytyqi nuk do të harrohet asnjëherë.



Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka mbajtur konferencë për medie

Jashari: Po përpiqen të më bllokojnë

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka kritikuar të martën asamblistët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës Kosova e Re (AKR) dhe Lëvizjes Vetëvendosje për përpjekje të bllokimit të punës së tij si kryetar i komunës. Ai ka bërë me dije se këtë po e bëjnë duke i braktisur mbledhjet e Kuvendit Komunal. Jashari ka thënë se këto veprime nga asamblistët po bëhen për interesa të ngushta të disa individëve. Sipas të parit të Skenderajt, prapa këtyre tentimeve për bllokim qëndron kryetari i Degës së PDK-së, Sami Lushtaku

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka kritikuar të martën asamblistët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës Kosova e Re (AKR) dhe Lëvizjes Vetëvendosje se po përpiqen që përmes bojkotit të seancave të Kuvendit Komunal ta bllokojnë punën e tij si kryetar. Pasi asamblistët lëshuan mbledhjen e Kuvendit Komunal, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka mbajtur një konferencë për medie, në të cilën ka akuzuar këshilltarët komunalë se këto veprime po i bëjnë për interesa të ngushta. Ai ka paralajmëruar se askush nuk do të mund ta bllokojë punën e tij si kryetar komune. "Fillimisht pjesa e këshilltarëve komunalë të grupit të PDK-së lëshuan seancën e datës 30 janar, duke provuar për ta bllokuar zgjedhjen e komiteteve funksionale obligative për funksionimin e Kuvendit, por në bashkëveprim me këshilltarët e partive opozitare arritëm t'i kompletojmë këto komitete. Sot vazhdimin e seancës e bllokuan edhe një pjesë e këshilltarëve të tjerë të Skenderajt", ka thënë Jashari. Ai ka deklaruar se me braktisjen e seancës të martën asamblistët e PDK-së, të AKR-së dhe të LV-së kanë treguar se janë kundër ndërtimit të një parku të biznesit në Morinë, i cili, sipas tij, do të ndikonte në zhvillimin ekonomik të Komunës së

Skenderajt. "Ne arritëm ta fillojmë si procedurë dhe për këtë na u dashtë mbështetja e Kuvendit Komunal të Skenderajt për t'i hapur rrugë zhvillimit ekonomik të qytetit. Njëpërmjet këtij vendimi për shpalljen e interesit publik për qytetarët e Skenderajt parku i biznesit i planifikuar të ndërtohet në lokacionin Morinë, pronë e AKP-së, e që kjo pronë të shpallet interes publik për komunën tonë, e cila do të ofronte mundësi të mëdha për zhvillimin ekonomik të qytetit të Skenderajt", është shprehur ai, duke përmendur me emra asamblistët që lëshuan mbledhjen. "Kjo po i pengon ish-kryesuesit të Kuvendit Komunal, i cili ka qenë që nga paslufta, Ismet Salihut. Po i pengon dajës së babës tim, Jetullah Gecit, që ka qenë komandat i Brigadës 112 për çlirim të këtij vendi dhe sot është pengesë e zhvillimit të këtij vendi. Po ashtu, po i pengon Sahit Çitakut, po i pengon Rasim Shalës, i cili është dhëndëri i dajës së babës tim. Po i pengon Lavdije Gecit, po i pengon Alban Osmanit, po i pengon Fitore Mangjollit, veterani të UÇK-së, Latif Smakqit, kushëriri të Tahir Mehës, Besarta Mehës dhe Adelin Spahiu. Po ashtu, me keqardhje e them se në seancën e fundit kanë qëndruar në mbledhje, por sot iu bashkëngjiten këtij grupi të PDK-së për bojkotim edhe pjesëtarët e AKR-së: Agron Kajtazi, Pajazit Isufi dhe Drenusha Hajzeri-Geci.



Gjithashtu, kjo çështje po i pengon, që mua më befason, Lëvizjes Vetëvendosje, e cila ka akuzuar qeverisjen e kaluar. Po ashtu, po i pengon Malsor Bejtës dhe Donika Rushitit", ka thënë Jashari.

Ai i ka ftuar qytetarët e Skenderajt që vetë t'i pyesin këta zyrtarë komunalë se pse po veprojnë në këtë mënyrë. "Pse nuk janë ata në nivelin e detyrës për të cilën paguhen, të cilët ju i votuat me votën e juaj për t'i mbrojtur interesat e juaja dhe për të krijuar zhvillim ekonomik. Kjo, si duket, po ua prish rahatimin nëpër ato prona të AKP-së apo edhe të pretenduesve të tyre. Po iu pengon kompleksit sportiv, që të rinjtë tanë të kenë ku të argëtohen. Nëse kështu vazhdon kjo logjikë e bllokimit të punës së Kuvendit Komunal, atëherë ne do të veprojmë konform dispozitave ligjore në fuqi në mënyrë që të dalim faqebardhë kundër besimit që na kanë dhënë qytetarët e Skenderajt", është shprehur Bekim Jashari.

Më tej, ai ka bërë me dije se askush nuk do të mund ta bllokojë punën e tij në krye të

komunës, duke paralajmëruar se askujt nuk do t'ia fshehtë të këqij. "Nuk janë duke lënë asnjë formë të mundshme pa e shfrytëzuar për interesa të ngushta personale të tyre, por jo të Bekim Jasharit. Besoj se Bekim Jashari e ka dëshmuar për të mirë se çfarë interesash ka për këtë vend. Nuk dua të lëshohem më shumë, sepse drejtësia do të merret me të gjitha ato prona që i kanë zuzuruar dhe i kanë dhënë në mënyrë të paligjshme", ka thënë i pari i Komunës së Skenderajt. Bekim Jashari ka deklaruar se parapa gjithë këtyre bllokimeve qëndron kryetari i Degës së PDK-së në Skenderaj, Sami Lushtaku. "Të gjitha këto lidhen me interesat e ngushta të këtyre individëve që unë i përmenda, e pikërisht kryetarin të Degës PDK-së, Sami Lushtaku, i cili ka qenë edhe kryetar i kësaj komune dhe njerëzve të tij. Ata e dinë mirë çfarë kanë bërë në këtë vend. Kanë marrë informata që Bekimi nuk do t'ua mbulojë të këqijat askujt, e kjo po u dhemb atyre. Bekimi do t'ju dalë përballë të gjithëve", është shprehur ai.

Madje Jashari ka thënë se Sami Lushtaku është duke e sabotuar punën e tij sikurse ka bërë para luftës me familjarët e tij. "Mua më befasoj fakti sot pse tre këshilltarët e AKR-së nuk erdhën, e që kanë qenë në seancën e fundit dhe për shkak të mungesës së tyre nuk patëm kuorum. Pse ata iu bashkëngjiten këtij grupi? Sepse po tentohet të më bllokojnë dhe të më sabotojnë. Sami Lushtaku nuk më befason aspak. Ai edhe babën tim dhe axhën tim në vitin 1993 i ka lënë. Pesë vjet ka ikur në mërgim në Gjermani. Pra, nuk më befason sjellja e tij, sepse është po ai Samiu që ka qenë atëherë", ka thënë Bekim Jashari.

Jashari e ka akuzuar Lushtakun edhe për çështje të tjera. "Dua t'juaja them një rast. Vetërinë zyrtare të kryetarit të Komunës së Skenderajt, të cilën e ka vozitur Sami Lushtaku deri më 11 dhjetor, unë e kam marrë me dy goma të dimrit dhe me dy goma të verës", ka thënë Jashari. Ndërkaq Dega e PDK-së në Skenderaj ka treguar arsyen pse asamblistët e saj të martën e kanë lëshuar mbledhjen e Kuvendit Komunal. Përmes një komunikate për medie kjo parti ka treguar se nuk është pajtuar me mënyrën e thirrjes së seancës, prandaj edhe asamblistët e saj e kanë lëshuar mbledhjen. Pavarësisht prej kësaj, Dega e Bekim Jashari ka deklaruar se do ta mbështesin çdo iniciativë të kryetarit të kësaj komune, Bekim Jashari. "E informojmë opinionin publik dhe qytetarët e Skenderajt se grupi i asamblistëve të PDK-së në Kuvendin Komunal të Skenderajt nuk ka sabotuar dhe nuk do ta sabotojë punën e Kuvendit dhe të kryetarit të komunës Bekim Jashari, përkundrazi do të mbështesë çdo iniciativë dhe projekt që është në të mirë të qytetarëve të Skenderajt", është thënë në njoftimin e Degës së PDK-së në Skenderaj.

Mjegulla, shkaktare e anulimit të vizitës së kryeministrit të Malit të Zi në Kosovë

PRISHTINË, 6 SHKURT - Vizita e kryeministrit të Malit të Zi në Prishtinë, Dushko Markoviq, e paraparë të zhvillohet të martën, është anuluar. Vizita e Markoviqit në Kosovë është anuluar për shkak të mjegullës së dendur që ka penguar uljen e avionit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Zëdhënësjë e Qeverisë së

Kosovës, Donjeta Gashi, ka bërë me dije për "REL" se për kohën dhe vizitën e kryeministrit malazez në Kosovë mbetet të ketë një koordinim të ri ndërmjet qeverive përkatëse. Vizita e kryeministrit të Malit të Zi ka qenë e paraparë të zhvillohet në kohën kur Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka shtyrë shqyrtimin dhe votimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së

demarkacionit për shkak të mungesës së koncesionit politik. Marrëveshja është nënshkruar në vitin 2015.

Kuvendi i Malit të Zi e ka ratifikuar atë, por jo edhe ai i Kosovës.

Marrëveshja aktuale e demarkacionit me Malin e Zi është kontestuar kryesisht nga partitë opozitare, duke thënë se me të Kosova humbet territor.



Bashkimi Evropian (BE) ka publikuar strategjinë e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor

BE-ja hap dyert për anëtarësim dhe kërkon plotësimin e kriterëve



Bashkimi Evropian ka prezantuar të martën strategjinë e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, me ç'rast është konfirmuar e ardhmja e tyre në një Evropë stabile, të fortë dhe të bashkuar. BE-ja ka kërkuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor përpjekje të qëndrueshme dhe reforma të paktyeshme. Strategjia e re ka parashikuar afate kohore vetëm për Serbinë dhe Malin e Zi, sipas së cilës, këto dy vende mund të anëtarësohen në BE diku në vitin 2025. Përderisa vendet e tjera si Shqipëria, Maqedonia, Bonjë e Hercegovina dhe Kosova janë përfshirë në Strategjinë e Zgjerimit, por pa ndonjë afat kohor për anëtarësim

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Komisioni Evropian të martën ka miratuar strategjinë e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor duke konfirmuar të ardhmen evropiane të gjashtë vendeve të tij si investim gjeostrategjik në një Evropë stabile, të fortë e të bashkuar dhe të bazuar në vlera të përbashkëta. Strategjia nënvizon nevojën që Bashkimi Evropian të jetë i gatshëm të mirëpresë anëtarë të rinj pasi t'i kenë përmbyshur kriteret. Në këtë strategji janë përcaktuar prioritetet dhe sfidat specifike me të cilat përballat Ballkanit Perëndimor, në veçanti nevojën për reforma thelbësore dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë. Po në këtë strategji është theksuar se si të vetmet vende në rajon që po negociojnë për anëtarësim janë Mali i Zi dhe Serbia. Sipas kësaj strategjie, këto dy vende mund të anëtarësohen në BE diku në vitin 2025. Megjithatë, është thënë se vendet e tjera mund t'i arrijnë ose t'i kalojnë, në varësi të përparimit objektiv të arritur.

Kurse Shqipëria dhe Maqedonia po bëjnë përparim të rëndësishëm dhe mund t'i hapin negociatat e anëtarësimit. Ndërsa me përpjekje dhe angazhim të qëndrueshëm, Bosnja dhe Hercegovina mund të bëhet kandidat për anëtarësim. Ndërkaq Kosova ka një mundësi për progres të qëndrueshëm përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për të avancuar në rrugën e saj evropi-

ane, kur ta lejojnë rrethanat objektive.

Sipas kësaj strategjie, të gjitha vendet duhet të japin zotime të qarta, në letër dhe në vepër për tejkalimin e çështjeve të së kaluarës, duke arritur pajtim dhe zgjidhje të çështjeve të hapura, veçanërisht kontesteve kultitare para anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në veçanti është thënë se duhet të ketë marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërish të detyrueshme të normalizimit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në mënyrë që ato të mund të avancojnë në rrugët e tyre evropiane. "Për Serbinë kërkohet vullnet i fortë dhe i qëndrueshëm politik për të arritur konsensus mbi reformat thelbësore të nevojshme për sundimin e ligjit dhe ekonominë, si dhe për ta nxitur pajtimin. Kjo duhet të mbështetet me një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Kosovën. Në mënyrë që të realizohet perspektiva ambicioze e vitit 2025. Duhet të arrihet dhe zbatohet një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin. Progresi në rrugët evropiane të Serbisë dhe të Kosovës është i lidhur ngushtë me progresin për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. Pa një normalizim efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve Beograd - Prishtinë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja nuk mund të ketë stabilitet të qëndrueshëm në rajon. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse

dhe ligjërish të detyrueshme normalizimi është urgente dhe vendimtare në mënyrë që Serbia dhe Kosova të përparojnë në rrugën e tyre evropiane", është theksuar në strategjinë e zgjerimit të BE-së. Sipas kësaj strategjie, rrugëtimi evropian i Ballkanit Perëndimor bazohet në meritat e vendeve dhe në shpejtësinë e tyre, varësisht nga rezultatet konkrete.

Strategjia shpjegon hapat që duhet të ndërmerren nga Mali i Zi dhe Serbia për ta përfunduar procesin e anëtarësimit në perspektivën 2025 përderisa vendet e tjera mund ta zënë hapin. "Mali i Zi dhe Serbia janë dy vendet e vetme me të cilat tashmë kanë filluar bisedimet e anëtarësimit. Kjo perspektivë përfundimisht do të varet nga vullneti i fortë politik, realizimi i vërtetë dhe i qëndrueshëm i reformave, si dhe zgjidhjet përfundimtare të kontesteve me fqinjët. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mundësinë të lëvizin përpara në rrugët e tyre evropiane. Komisioni i vlerëson të gjitha vendet në mënyrë të drejtë dhe objektive, bazuar në meritat e tyre vetjake dhe në shpejtësinë sipas së cilës ato arrijnë progres. Shqipëria dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë duke shënuar progres të ndjeshëm në rrugët e tyre evropiane dhe komisioni është i gatshëm t'i përgatisë rekomandimet për hapjen e negociatave të anëtarësimit, në bazë të kushteve të

përmbyshura. Komisioni do të fillojë të përgatisë një opinion lidhur me aplikimin për anëtarësim të Bosnje dhe Hercegovinës pas pranimit të përgjigjeve gjithëpërfshirëse dhe të plota në pyetësorin e saj. Me përpjekje dhe angazhim të qëndrueshëm, Bosnje dhe Hercegovina mund të bëhet kandidat për anëtarësim. Kosova ka një mundësi për progres të qëndrueshëm përmes zbatimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit dhe për ta avancuar rrugëtimin e saj evropian, sapo të lejojnë rrethanat objektive", është theksuar në strategjinë e zgjerimit të BE-së.

Komisioni Evropian ka përcaktuar gjashtë nisma kyçe të cilat do të fuqizojnë më tutje bashkëpunimin dhe do ta mbështesin procesin e transformimit në Ballkanin Perëndimor. "Këto nisma kyçe synojnë fusha specifike të interesit të përbashkët: sundimi i ligjit, siguria dhe migrimi, zhvillimi socio-ekonomik, transporti dhe lidhja energjetike, agjenda digjitale, pajtimi dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Veprimet konkrete në këto fusha parashihen në periudhën 2018-2020", është theksuar në strategji.

Megjithatë, është thënë se ka shumë punë për t'u bërë që vendet e rajonit të jenë në gjendje t'i përmbyshin kushtet dhe kriteret për anëtarësimin në BE. Strategjia nënvizon që liderët në rajon nuk duhet të lënë asnjë dyshim lidhur me orientimin dhe zotimin e tyre strategjik. Përfundimisht do të jenë ata që duhet ta marrin përsipër përgjegjësinë për ta bërë këtë mundësi historike një realitet. Gjithashtu, në këtë strategji është theksuar se BE-ja vetë duhet të jetë gati për anëtarë të rinj të familjes sapo t'i kenë përmbyshur kushtet. Po ashtu, është thënë se duhet të vendosen aranzhime të veçanta për të siguruar që shtetet

e ardhshme anëtare nuk janë në pozitë ta bllokojnë anëtarësimin e vendeve të tjera kandidate të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë negociatave vendet kandidate për anëtarësim duhet t'u japin përparësi vendimtare sundimit të ligjit, drejtësisë dhe të drejtave themelore.

Strategjia përcakton qartë se dera e BE-së është e hapur për aderime të mëtejshme atëherë dhe vetëm atëherë kur vendet individuale t'i kenë përmbyshur kriteret. "Komisioni nuk është duke e ndryshuar politikën e tij të zgjerimit: procesi është dhe mbetet merit. Çdo vend do të vlerësohet për arritjet e veta", është thënë në strategji. Me strategjinë e re Komisioni Evropian rekomandon të vendosen zgjidhje të veçanta dhe të paktyeshme për t'u siguruar që shtetet e ardhshme anëtare nuk do të jenë në gjendje ta bllokojnë anëtarësimin e kandidatëve të tjerë të Ballkanit Perëndimor.

Junker: Komisioni Evropian do të jetë rigoroz dhe i drejtë

Strategjia për vendet e Ballkanit Perëndimor është prezantuar të martën në një konferencë të përbashkët për medie nga presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini dhe komisionari për Zgjerim, Johannes Hahn.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, ka thënë se me vullnet të fortë politik, reforma reale e të qëndrueshme, si dhe me zgjidhjen përfundimtare për konteste me fqinjët, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të ecin tutje në rrugët e tyre evropiane. "Investimi në stabilitetin dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor do të thotë investim në sigurinë dhe të ardhmen e



deklaruar Juncker. Ndërkohë përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, ka thënë se Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës dhe, sipas saj, kjo strategji siguron një perspektivë të qartë për integrimin e secilit vend. "Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës. Ne ndajmë të njëjtën histori, të njëjtën gjeografi, të njëjtën trashëgimi kulturore dhe të njëjtat mundësi dhe sfida, sot dhe në të ardhmen. Ne kemi interes të përbashkët të punojmë gjithnjë e më afër njëri-tjetrit për t'i garantuar popullit tonë zhvillim ekonomik dhe social, si dhe siguri. Kjo strategji tregon rrugën që kemi para ne: që të gjashtë partnerët tanë ta tejkalojnë njëherë e përgjithmonë të kaluarën, që të gjithë së bashku ta bëjmë procesin e Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian të pakthyesëm dhe ta vazhdojmë ribashkimin e kontinentit. Kjo strategji siguron një perspektivë të përbashkët, të qartë, të paekuivokë, të besueshme dhe konkrete për integrimin evropian të secilit nga gjashtë partnerët tanë. Muajt në vijim jo vetëm se do të jenë intensivë, por edhe vendimtarë për të siguruar që nuk humbet kjo mundësi historike dhe unike", është shprehur Mogherini.

Edhe komisionari për politikën evropiane të fqinjësisë dhe negociatat e zgjerimit, Johannes Hahn, ka thënë se me anë të kësaj strategjie konfirmohet se dera e BE-së është e hapur për Ballkanin Perëndimor. "Me qasjen e re, të mbështetur me masa konkrete, do ta forcojmë procesin e zgjerimit, i cili nga ana tjetër kërkon angazhim dhe reforma të besueshme, veçanërisht për forcimin e sundimit të ligjit. Duhet të punojmë për të mirën e qytetarëve", ka deklaruar Hahn.

Edhe komisionari për politikën evropiane të fqinjësisë dhe negociatat e zgjerimit, Johannes Hahn, ka thënë se me anë të kësaj strategjie konfirmohet se dera e BE-së është e hapur për Ballkanin Perëndimor. "Me qasjen e re, të mbështetur me masa konkrete, do ta forcojmë procesin e zgjerimit, i cili nga ana tjetër kërkon angazhim dhe reforma të besueshme, veçanërisht për forcimin e sundimit të ligjit. Duhet të punojmë për të mirën e qytetarëve", ka deklaruar Hahn.

Kosova mirëpret strategjinë e BE-së për Ballkanin Perëndimor

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka treguar se strategjia e zgjerimit të BE-së në parim tregon qartë perspektivën evropiane të Kosovës. Në profilin e tij në "Facebook" ai ka shkruar se Kosova ka merituar dhe ka pritur më shumë nga kjo strategji. Sipas tij, perspektiva evropiane e Kosovës është e pandalshme. "Është lajm i mirë që për herë të parë vendet anëtare të BE-së e pranojnë dhe e trajtojnë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran, përfshirë shtetet anëtare të BE-së që nuk na kanë njohur. Kosova do të vazhdojë rrugën e zhvillimit dhe integrimit euroatlantik, duke përbushur të gjitha obligimet që ka", ka shkruar Veseli. Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka

mirëpritur publikimin e strategjisë së Bashkimit Evropian për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, pjesë e së cilës është edhe Kosova. Ajo ka thënë se me anë të kësaj strategjie Kosovës i është hapur dera për t'u bërë pjesë e BE-së. Sipas Hoxhës, është tejet pozitive që BE-ja ka konfirmuar se Kosova e ka vendin në BE dhe ka rrugën e vet të ndarë nga Serbia në këtë proces. Po ashtu, edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se strategjia e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor në të cilin përfshihet edhe shteti ynë, tregon se perspektiva evropiane e gjashtë shteteve të këtij rajoni është e hapur.

Limaj ofron përkrahjen e Qeverisë për FSK-në

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka pritur të martën në takim zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj dhe ministrin e Infrastrukturës Pal Lekaj. Pjesë e këtij takimi ishin edhe zëvendësmministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rahman Rama. Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka falënderuar zëvendëskryeministrin Limaj për vizitën dhe anëtarët e tjerë të delegacionit, si dhe i ka njoftuar

ata me zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme të MFSK-së dhe të FSK-së. Gjithashtu, ministri Berisha e ka informuar Limajin për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, për memorandumet e bashkëpunimit me shtetet anëtare të NATO-s, duke theksuar bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Po në këtë takim është folur edhe për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant

Rahman Rama, ka folur për arritjet e përgjithshme dhe individuale të kadetëve të FSK-së, në akademitë më prestigjioze në botë, si në ShBA, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Turqi, Shqipëri etj. Ndërkaq zëvendësmministri Fatmil Limaj ka përgëzuar ministrin Berisha dhe komandantin e FSK-së për arritjet e përgjithshme, duke premtuar përkrahjen e tij dhe të Qeverisë së Kosovës për Ministrinë e FSK-së dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.



OSBE-ja i dhuron policisë mjete të specializuara të ndihmës së parë

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka dhuruar Policisë së Kosovës 30 çanta me mjete të specializuara të ndihmës së parë. Këto mjete do të përdoren nga Njësia për Operacione Speciale dhe ajo për Reagim të Shpejtë e Policisë së Kosovës. Sipas OSBE-së, çantat përmbajnë mjete të cilësisë së lartë dhe do të shfrytëzohen nga njësitet për t'ua dhënë ndihmën e parë policëve të lënduar në detyrë. Ambasadori i OSEB-së në Kosovë, Jan Braathu, ka thënë se njësitet speciale dhe ato të reagimit të shpejtë janë të ekspozuara ndaj rrezikut, meqë ofrojnë siguri dhe mbajnë rendin publik gjatë protestave apo ngjarjeve të tjera me potencial dhune. "Puna e policisë është e vështirë dhe herë pas here e rrezikshme, prandaj është shumë e rëndësishme që ata që i ekspozohen një rreziku të tillë ta dinë që e kanë përkrahjen



dhe mjetet e nevojshme për ta kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme", ka thënë Braathu gjatë ceremonisë së dorëzimit-pranimi të këtyre mjeteve. Ndërsa nënkolonel Neshat Flugaj, drejtor i Divizionit të Njësive Speciale të Policisë, ka thënë se ky donacion është një hap para në

drejtim të përmirësimit të sigurisë së policëve. Misioni i OSBE-së ka dhuruar edhe dy mijë karta informative të sigurisë, të cilat mund t'u shpërdahen gazetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe organeve mbikëqyrëse të policisë, të pranishëm në tubime publike.

Kryetari i Gjykatës Supreme ka pritur në vizitë një delegacion turk

Turqia e gatshme ta ndihmojë Kosovën në fushën e drejtësisë

Zëvendësministri i Drejtësisë së Turqisë, Bilal Uçar, gjatë vizitës në Kosovë ka shprehur interesimin e vendit të tij për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy shteteve në fushën e drejtësisë

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, të martën ka pritur një delegacion nga Turqia, i kryesuar nga zëvendësministri i Drejtësisë, Bilal Uçar. Uçar ka shprehur interesimin e vendit të tij për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy shteteve në fushën e drejtësisë.

Në anën tjetër, edhe kreu i Supremes u zotua se bashkëpunimi dhe respektimi i ndërsjellët do të vazhdojë gjithmonë dhe se Kosova i është mirënjohëse Turqisë për ndihmën që ka dhënë në vazhdimësi për forcimin e institucioneve shtetërore, posaçërisht të pushtetit gjyqësor. Po ashtu, kryetari Peci i ka njoftuar të pranishmit me

kompetencat e Gjykatës Supreme, me punën që aktualisht është duke u bërë dhe me problemet nëpër të cilat po kalon sistemi gjyqësor aktualisht. "Si gjykatë jemi shumë efektivë. Jemi duke i trajtuar lëndët e pranuarë në fund të vitit 2017. Kemi vetëm edhe rreth 250 raste të papërfunduara. Por, gjyqësori në përgjithësi ka probleme. Sidomos Gjykata Themelore e Prishtinës, e cila ka numër të madh të lëndëve të pazgjidhura", ka sqaruar Peci, duke bërë me dije se po bëhen përpjekje për ta shtuar numrin e gjyqtarëve. Sipas tij, Kosova po i vuan ende pasojat e të kaluarës. "Historikisht, Kosova ka kaluar në rrugë të vështira. Gjyqësori nuk ekziston vetëm prej përfundimit të luftës. Kemi një gjyqësor që ka



ekzistuar edhe në ish-Jugosllavi. Doktrina juridike nuk ndryshon shumë, porse kemi pasur një luftë shkatërruese, e cila prej viteve të '90-ta deri në vitet 2000 e ka paralizuar situatën, ndaj në njëfarë aspekti, pasojat po i vuajmë ende", ka thënë Peci. Në këtë drejtim, i pari i pushtetit gjyqësor u shpreh mirënjohës për kontributin e

Turqisë për çlirimin e Kosovës dhe tutje për forcimin e saj si shtet. Të dyja palët u pajtuan që ta rrisin bashkëpunimin dhe t'i shkëmbejnë përvojat në fushën e drejtësisë duke ndihmuar kështu në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit. Edhe kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka pritur zëvendësministrin e Turqisë, Bilal Uçar. Në këtë takim ka

marrë pjesë edhe ambasadorja e këtij vendi në Kosovë, Kivilcim Kiliçi.

Kryeprokurori Lumezi ka thënë se ngritja e bashkëpunimit në fushën juridike ndërkombëtar do të jetë e dobishme për dy vendet në luftën e përbashkët të dukurive kundërligjore të nivelit vendor, rajonal dhe më gjerë.



Ambasada e Zvicrës ofron përkrahje për zbardhjen e personave të zhdukur

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Këshilltari i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, Jahja Lluka, njëherësh mbajtës i dosjes për çështjen e personave të zhdukur, ka takuar përfaqësuesit e Ambasadës së Zvicrës, me të cilët ka biseduar për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur. Lluka ka falënderuar

për përkrahjen e vazhdueshme të Ambasadës së Zvicrës në këtë proces. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës e ka prioritet çështjen e personave të zhdukur. Po ashtu, Lluka ka njoftuar përfaqësuesit e Ambasadës së Zvicrës edhe për aktivitetet dhe takimet e realizuara me përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe

organizatave ndërkombëtare të angazhuara në këtë proces. Përfaqësuesi i Ambasadës së Zvicrës, Kuno Schlaefli, duke vlerësuar lart qasjen e re dhe serioze të Qeverisë Haradinaj ndaj procesit të ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, ka ofruar përkrahje për zbardhjen e personave të zhdukur.

Kryeparlamentari Veseli, vizitë zyrtare në Kroaci

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka udhëtuar të martën për vizitë zyrtare në Kroaci, ku do të pritet nga autoritetet më të larta shtetërore në Zagreb. Gjatë kësaj vizite zyrtare kryeparlamentari Veseli do ta takojë homologun kroat, kryeparlamentarin Gordan Jandroković, me të cilin do të diskutojë për bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet parlamenteve të dy shteteve.

Në një takim të posaçëm, kryepar-

lamentari Kadri Veseli do të pritet edhe nga kryeministri kroat, Andrej Plenković, ku do të diskutohet për zhvillimet politike dhe për thellimin e bashkëpunimit ekonomik e politik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë.

Gjatë qëndrimit në Zagreb, kryeparlamentari kosovar do të marrë pjesë edhe në pritjen e Ambasadës së Kosovës në Kroaci për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, ku pritet të marrin pjesë edhe qytetarë të Kosovës që jetojnë në Kroaci.



Projektligji për Inspektoratin e Arsimit dërgohet në Kuvend

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Arsim, në të cilën është diskutuar për Projektligjin për Inspektoratin Arsimit, me ç'rast me shumicë votash është vendosur që ky ligj të dërgohet në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës. Ministri Bytyqi ka thënë se ky ligj do të ketë rol kyç për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar

**EPOKA
ERE** **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, të martën, me 9 vota për dhe një abstenim, e ka dërguar në Kuvendin e Kosovës për lexim të parë Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit. Me këtë rast, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka thënë se ky ligj do të ketë rol kyç për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar. Ai ka theksuar se Ligji për Inspektoratin e Arsimit do të jetë edhe bazë për ta menaxhuar dhe përcjellë edhe

administrimin e legjislativ të gjitha nivelet e arsimit.

Në kuadër të sfidave që priten në sektorin e arsimit, ministri Bytyqi ka përmendur nevojën e rritjes së numrit të inspektorëve të arsimit (40 inspektorë) dhe, si rrjedhojë, edhe rritjen e buxhetit. "Mbetet që me akte nënligjore t'i rregullojmë edhe procedurat dhe vlerësimet e performancës së mësimdhënësve, gjë që do të ndikojë në rritjen e përgjegjësisë dhe angazhimit profesional dhe, si rezultat, edhe në ngritjen cilësisë në arsim", ka thënë Bytyqi.

Kurse deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka propozuar që pjesë e inspek-



timit të jenë edhe nxënësit dhe mësimdhënësit. "Propozim konkret kam se pjesë e inspektimit duhet të jenë edhe mësimdhënësit dhe nxënësit. Mendoj se çdo katër vjet profesorët e një shkolle ta vizitojnë shkollën tjetër dhe t'i inspektojnë kolegët e vet", ka thënë ajo. Ndërkaq deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, ka bërë apel që

në inspektimin e mësimdhënësve të jenë inspektorët e fushës së njëjtë, në mënyrë që të vlerësohet saktë performanca. Deputeti i PDK-së, Nezir Çoçaj, ka kërkuar të krijohet një agjenci e Inspektoratit të arsimit në Kosovë, i cili do të jetë i pavarur dhe i pandikuar politikisht. Kurse deputetja e Lëvizjes

Vetëvendosje, Arbërie Nagavci,

ka thënë se projektligji i përgatitur në mandatin e kaluar nga MASH-T-i nuk do duhej të kthehej tashmë prej fillimi, por të merrej ai projektligj. "Me pengon fakti se projektligjet gati të përfunduara po kthehen prej fillimit. Ka përzjerje në mes të kontrollit të cilësisë në arsim dhe zbatimit të procedurave", ka thënë Nagavci.

Kurti: Qeveria po pengon hetimin ndërkombëtar për Astrit Deharin

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për medie ka thënë të martën se Qeveria është duke penguar lejin e një hetimi ndërkombëtar për rastin e vdekjes së aktivistit të tyre Astrit Dehari. Ndërkaq Glauk Konjufca nuk ka përjashtuar mundësitë e protestave nëse Qeveria nuk i hap rrugë drejtësisë për Astrit Deharin

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe shefi i grupit parlamentar i kësaj lëvizjeje, Glauk Konjufca, kanë mbajtur të martën konferencë për medie për rastin e vdekjes së aktivistit të tyre Astrit Dehari. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke penguar lejin e një hetimi ndërkombëtar për rastin e vdekjes së aktivistit Astrit Dehari, i cili ndërroi jetë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor të vitit 2016. "Mungesa e hetimit të pavarur sot e kësaj dite, është pengesa e vetme e hetimeve të mëtejshme të këtij rasti. Sot janë bërë tre muaj që Qeveria hesht. Qeveria nuk po e lejon nisjen e hetimit të pavarur

ndërkombëtar siç është zotuar vetë", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se në burgun e Prizrenit, Astrit Deharin nuk e mori as sëmundja e as aksidenti. "Astritin e mori padrejtësia me të cilën ai luftonte me gjithë qenien. Astriti nuk ishte thjesht në burg. Ishte i paraburgosur", është shprehur Kurti.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, nuk ka përjashtuar mundësitë e protestave të organizuara nga ky subjekt partiak nëse, sipas tij, Qeveria e Kosovës nuk i hap rrugë drejtësisë për rastin e vdekjes së Astrit Deharit. "Nëse nuk merren masa e Qeveria e Kosovës nuk i hap rrugë drejtësisë për rastin Dehari, nuk përjashtohen as protestat", ka thënë Konjufca.

Ndaj deklaratave të zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje ka reagu



ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje është duke manipuluar me rastin e Astrit Deharit. "Albin Kurti vazhdon të manipulojë me një diskurs që në njërin anë privatizon individin, në anën tjetër është përjashtues ndaj shoqërisë dhe institucioneve shtetërore. Këtë praktikë e zbatoi edhe sot në një konferencë për

medie. Ndiej keqardhje për mënyrën se si ende manipulohet me rastin e të ndjerit Dehari dhe mbi mënyrën se si Albin Kurti përpjetë t'u vë gjërave konkrete, mjegullën e tij ideologjike", ka thënë ministri Tahiri. Ai ka bërë me dije se që në fillim të mandatit të tij si ministër është përkushtuar për të bërë të mundur një super-ekspertizë ndërkombëtare për rastin Dehari. "Madje me

kërkesë të prindërve kemi tejkaluar edhe rekomandimet e Kuvendit duke bërë të mundur që kjo ekspertizë të kryhet në një institut në Zvicër, konform kërkesës së tyre", ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se prokurori i rastit përmes Ambasadës së Zvicrës ka vënë kontakte dhe është në komunikim e sipër me institutin zviceran, me qëllim të qartësimit të plotë të vdekjes së Astrit Deharit.

Hamza interesohet për përvojën e Sllovenisë në reformën e TVSh-së

LUBJANE, 6 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, është duke qëndruar për vizitë zyrtare në Republikën e Sllovenisë. Ai të martën është pritur në takim nga ministrja e Financave të Sllovenisë, Mateja Vranicar Erman, me të cilën ka diskutuar për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy vendeve, me theks të veçantë për bashkëpunimin ndërmjet ministrit. Ministri Hamza e ka njoftuar homologen sllovene për progresin dhe të arriturat në të gjitha fushat në Kosovë, në veçanti fushën e financave si dhe për reformat fiskale që janë ndërmarrë kohët e fundit nga Ministria e Financave për ta mbështetur sektorin privat. Me këtë rast, ministri Hamza ka

kërkuar mbështetjen e Ministrisë së Financave të Sllovenisë për përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe administrative, teknologjise informative, për fillimin e reformës më të madhe në Kosovë deri më tani, e që është bartja e mbledhjes së TVSh-së nga kufiri në brendi të vendit. Ndërsa ministrja e Financave të Sllovenisë, Mateja Vranicar Erman, ka shprehur gatishmërinë e ministrisë që drejton për ta mbështetur Kosovën për implementimin sa më të mirë të reformës së TVSh-së, të cilën reformë Sllovenia e ka filluar së implementuar nga qershori i vitit 2016. Sipas saj, kjo reformë shkon në të mirë të bizneseve dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.



Franca i ofron bashkëpunim MTI-së



PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Zëvendësiministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Faton Thaçi, ka pritur të martën në takim Joseph Giustiniani, atashë për bashkëpunimin në ambasadën e Francës në Kosovë, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Institutit Kosovar për Pronësi Industriale, Veli Hoti. Temë e diskutimit në këtë takim ishte bashkëpunimi i shtetit të Francës me shtetin e Kosovës në fushën e pronësive industriale (intelektuale), konkretisht në treguesit gjeografikë. Zëvendësiministri Thaçi e ka njoftuar atashëun Giustiniani me të

arriturat e Agjencisë së Pronësive Industriale, që vepron në kuadër të MTI-së, për përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe institucionale konform direktivave të BE-së, avancimet në teknologjinë e bazës të të dhënave për markat tregtare, pronësinë intelektuale dhe treguesit gjeografikë. Thaçi ka pohuar se procedurat për aplikim, publikim, komunikim dhe regjistrim janë tashmë të ndërtuara dhe të zhvilluara nga API, kështu që nuk kërkohet ndonjë rirregullim pasi, sipas tij, janë të njëjta apo të ngjashme me regjistrimin e objekteve të tjera të pronës industriale: marka

tregtare, patenta dhe dizajne industriale. Atashëu francez Giustiniani e ka siguruar zëvendësiministri Thaçi se do të ketë mbështetje të pakursyer në drejtime të ndryshme, qoftë teknike, financiare dhe me ekspertë francezë dhe në koordinim në mes të MTI-së, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Shoqatës së Prodhuesve të Djathit të Sharrit, që në muajt në vijim të mbahen takime dhe punëtori të ndryshme me ekspertë nga Franca dhe ekspertë që mbulojnë këto fusha në ministrinë relevante.

Zëvendësiministri Dukolli: Do ta luftojmë ekonominë joformale

SHKUP, 6 SHKURT (ER) - Zëvendësiministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ferit Dukolli, ka marrë pjesë në konferencën e parë rajonale "Ekonomia e Fshehur" të mbajtur në Shkup të Maqedonisë, konferencë kjo e organizuar nga Qendra për Hulumtim dhe Politikbërje (Maqedoni), Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Shqipëri) dhe Demokracia për Zhvillim (Kosovë). Në emër të MPMS-së, zëvendësiministri Dukolli ka përgëzuar organizatorët e konferencës, duke thënë se organizimi me tematikë të tillë kontribuojnë në ngritjen e bashkëpunimit, avancimit dhe adresimit të sfidave të ekonomisë së fshehur, me të cilat përballen shoqëritë tona. Zëvendësiministri Dukolli ka theksuar përkushtimin e MPMS-së që në kuadër të ngritjes së nivelit të mirëqenies sociale dhe

realizimit të drejtësisë sociale, e ka edhe aspektin e vendosjes së standardeve juridike nga marrëdhënja e punës. "Me qëllim që të vendoset ligjshmëria në vend dhe të shënohet rritje ekonomike, Qeveria ka vendosur prioritet në punën e luftimit të ekonomisë joformale duke përfshirë edhe luftimin e punësimit joformal", ka thënë Dukolli. Duke folur rreth të drejtave të punëtorëve dhe luftimit të informalitetit, Dukolli ka informuar të pranishmit se MPMS-ja është duke bërë edhe plotësim-ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës. "MPMS-ja mbetet e angazhuar dhe e përkushtuar që ta ngrehë nivelin e respektueshmërisë së legjislacionit, luftimin e ekonomisë joformale brenda mandatit që ka, përmes mekanizmave juridikë", ka thënë zëvendësiministri Dukolli.



Gjermania ndihmon AUV-në për plotësimin e standardeve ushqimore të BE-së

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka vizituar të martën Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Ai ka thënë se Gjermania do ta përkrahë Kosovën për arritjen e qëllimeve të saj integruese drejt BE-së, sidomos për plotësimin e standardeve të sigurisë ushqimore të BE-së

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka vizituar të martën Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për t'u njohur nga afër me punën dhe të arriturat në këtë institucion. Ambasadori Heldt ka theksuar se Gjermania është një ndër vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ai ka përgëzuar AUV-në për laboratorët dhe pajisjet moderne dhe funksionale të cilat i ka. Heldt ka bërë me dije se Gjermania e përkrah Kosovën për arritjen e qëllimeve të saj integruese drejt BE-së, duke përfshirë përkrahjen e vazh-

dueshme ndaj Kosovës për t'i plotësuar standardet e sigurisë ushqimore të BE-së.

Kryeshafi ekzekutiv i AUV-së, Valdet Gjinovci, ka thënë se Gjermania është partnere e rëndësishme për Kosovën. Ai ka pohuar se Kosova dhe Gjermania janë të lidhura në marrëdhënie të ngushta tregtare. Të dyja palët u pajtuan se konsumatorët e Kosovës dhe ata evropianë kërkojnë siguri në ushqim dhe cilësi të lartë të ushqimit. Gjithashtu, në këtë takim u tha se siguria ushqimore është parakusht i domosdoshëm për promovimin e eksportit të produkteve bujqësore dhe për zhvillim ekonomik të vendit.



MBPZHR-ja dhe USAID-i, projekte të përbashkëta për zhvillimin e bujqësisë



Drejtori i USAID-it për Kosovë, James Hope, gjatë takimit me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, ka bërë me dije se mbështetja e USAID-it për MBPZHR-në do të vazhdojë përmes projekteve të ndryshme bujqësore

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Nenad Rikalo, ka pritur të martën në një takim drejtorin e USAID-it për Kosovë, James Hope, me të cilin kanë biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë, përmes investimeve në projekte të reja.

Ministri Rikalo e ka njoftuar

drejtorin e USAID-it me programin e ministrisë që drejton. Ai ka thënë se ky program në vazhdimësi ka sjellë rezultate dhe falë investimeve në bujqësi, është siguruar rritje ekonomike, vende të reja pune dhe rritje të prodhimit vendor. Po ashtu, ministri Rikalo ka folur edhe për prioritetet për këtë vit, me ç'rast ka ritheksuar se do t'i japin prioritet kryesor efikasitetit për implementimin e programeve mbështetëse për fermerët dhe agrobizneset.

Rikalo ka vlerësuar lart projektet e USAID-it të cilat po ndikojnë në zhvillimin dhe fuqizimin e sektorit të bujqësisë në vend. Ndërkaq drejtori i USAID-it, James Hope, ka vlerësuar angazhimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në mbështetje të fermerëve, duke çmuar bashkëpunimin që kanë si dy institucione. Hope ka theksuar se mbështetja e USAID-it do të vazhdojë përmes projekteve të ndryshme bujqësore.

Beqaj nënshkruan memorandum bashkëpunimi me 'James Madison University'

UASHINGTON, 6 SHKURT (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrjes, Besim Beqaj, është duke qëndruar për vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në kuadër të kësaj vizite ministri Beqaj do të ketë një varg takimesh dhe aktiviteteve të rëndësishme si dhe do të marrë pjesë në Lutjet e Mëngjesit. Ministri Beqaj të martën ka vizituar "James Madison University", ku është pritur nga presidenti i këtij universiteti,

Jonathan R. Alger, në kompleksin universitar Harrisonburg, një nga universitetet më të vlerësuar në ShBA, në veçanti për Qendrën për Ndërmarrësi, laboratorët dhe qasjen e re në edukim.

Pas vizitës në këtë institucion edukativ amerikan dhe pas takimeve me dekanët, drejtorët e qendrave dhe profesorët e këtij universiteti, ministri Beqaj dhe udhëheqësit e këtij institucioni nënshkruan memorandum bashkëpunimi për ndërtimin e

qendrave për inovacion dhe ndërmarrësi, programe dhe konferenca të përbashkëta, për hulumtim dhe zhvillim, shkëmbim të ekspertizës, studentëve dhe vizitave të ndërsjellta studimore. "Vizita në James Madison University dhe memorandum që nënshkruam me z. Alger është hap i rëndësishëm për ndërtimin e Qendrave të Inovacionit dhe Ndërmarrjes dhe për përfundimin nga përvoja amerikane në fushën e inovacioneve dhe ndërmarrjes", ka thënë Beqaj.



Lladrovci kërkon përrshpejtimin e procesit të privatizimit

DRENAS, 6 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me të cilët ka biseduar për identifikimin e asetëve të rëndësishme të Komunës së Drenasit, të cilat menaxhohen nga AKP-ja. Në

këtë takim pjesëmarrës ishin kryesuesi i Bordit të AKP-së, Petrit Gashi, zëvendëskryesuesi Bajram Zejnullahu, zëvendës-drejtoresha menaxhuese, Valbona Dibra dhe drejtori i koordinimit rajonal, Petrit Ibraj. Lladrovci ka falënderuar përfaqësuesit e AKP-së për vizitën dhe ka kërkuar nga AKP-ja



që konform mandatit që kanë, që pronat të cilat janë në interes të zhvillimit të komunës, të përjashtohen nga procesi i shitjes në mënyrë që

t'u jepet mundësia për kthimin e tyre në pronë komunale. Ndërsa kryesuesi i Bordit të AKP-së, Petrit Gashi, ka falënderuar kryetarin për takim dhe

ka informuar se pronat e identifikuar të cilat janë me interes publik për Komunën e Drenasit do të trajtohen me interes të veçantë.



'Infrakosi' pritet të investojë në Ferizaj

FERIZAJ, 6 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka pritur të martën në takim kryeshefin ekzekutiv të "Infrakos"-it, Agron Thaçi, si dhe deputetin e PDK-së, Elmi Reçica. Në këtë takim është diskutuar për disa çështje që kanë të bëjnë me përdorimin e hekurudhës si aset për zhvillimin ekonomik të Ferizajt. Kryetari Aliu ka thënë se pashmangshëm është diskutuar

edhe për hekurudhën e cila kalon nëpër Ferizaj. Po ashtu, ai ka thënë se kanë diskutuar edhe për projektet që tashmë janë pjesë e Ligjit të buxhetit të Kosovës. "Biseduam që së bashku me hekurudhat e Kosovës të formojmë një grup të përbashkët të ekspertëve që janë në kuadër të drejtorive të Komunës së Ferizajt, por edhe të këshillit konsultativ të ekspertëve të urbanizimit dhe, sigurisht, edhe nga

Hekurudhat e Kosovës, për të studiuar çdo detaj të projektit zbatues të bashkimit të qytetit. Pra, do të jetë një bashkëpunim i ngjeshur gjatë këtyre muajve me qëllim që të realizohet ky projekt", ka thënë Aliu. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i "Infrakos"-it, Agron Thaçi, është zotuar se të gjitha kërkesat e Aliut do të shqyrtohen një nga një në mënyrë që të realizohen sa më parë.

Dëmtohen zyrat e Vetëvendosjes në Dardanë

DARDANË, 6 SHKURT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se persona të paidentifikuar kanë dëmtuar të martën në mëngjes zyrat e kësaj lëvizje në Komunën e Dardanës. "Aktivistët i kanë gjetur zyrat në një gjendje me xhama të thyer dhe dysheme të mbushur plot gurë. Një akt i tillë nuk po ndodh për herë të parë karshi Lëvizjes Vetëvendosje. Por as ky, as ata të mëhershmit, nuk e kanë zmbur as trembur

Lëvizjen dhe aktivistët e saj. Dëmtimi i zyrave është bërë sigurisht me qëllim të keq dhe motivi është krejtësisht politik", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes. Lëvizja Vetëvendosje i ka bërë thirrje policisë ta zbardhë këtë rast. "Sulmuesve ua bëjmë të qartë se këto imtësi, sado të shëmtuara, nuk na ndalojnë as punën, as hovin dhe as qëllimin për të cilin angazhohemi", është thënë në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.



Qytetarët shumë shpejt do t'i gëzojnë përfitimet e Ligjit për Obiliqin

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi. Me këtë rast Haradinaj i ka premtuar Gashit përrshpejtimin e pro-

cedurave për zbatimin e Ligjit për Obiliqin. "Me kryetarin, Xhafer Gashi, diskutuam për dinamizimin e zbatimit të Ligjit për Obiliqin, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i premtuara përrshpejtimin e veprimeve,

të cilat janë në përgjegjësinë e Qeverisë dhe të ministrave përkatëse. Qytetarët e Obiliqit shumë shpejt do t'i gëzojnë përfitimet që sjell ky ligj", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Në prag të 10-vjetorit të pavarësisë

Pse kaq ngadalë integrimi i Kosovës në BE



Nga Mimoza KELMENDI

Perspektiva evropiane për Kosovën është bërë e ditur që nga Deklarata e Selanikut e qershorit 2003, megjithëse edhe më parë në mbledhjen e Këshillit Evropian të mbajtur në qershorin e vitit 2000 në Feira, Portugal, deklarohet se "vendet e Ballkanit Perëndimor konsideroheshin të gjitha vende kandidatë të mundshme për t'u anëtarësuar në BE dhe që një nga objektivat e BE-së duhej të ishte përfshirja e këtyre vendeve në proceset politike dhe ekonomike të Evropës".

Një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 18 shkurt 2008, Këshilli Evropian u mbledh dhe, duke marrë parasysh qëllimet e deklaruara nga liderët e Kosovës për shpalljen e pavarësisë, përcaktoi se vendet e BE-së do ta njohin republikën e re në përputhje me praktikat kombëtare dhe ligjin ndërkombëtar. Por rruga drejt BE-së duket edhe më e gjatë...

Cilat janë pengesat?

Integrimi evropian nuk duhet parë vetëm si një çështje statusi, procesesh juridike apo politike, përfshirë këtu edhe vetë fraza slogan "Integrim në Evropë". Gjithashtu, nuk duhet parë as si dekoratë, që të jepet pas një shërbimi apo veprimtarie të mirë. Në këtë sens integrimi i Kosovës në BE nuk duhet trajtuar vetëm si një proces zbatimi apo jo i detyrave "evropiane", sipas dokumenteve dhe deklaratave të Brukselit apo Strasburgut. Nuk duhet trajtuar as edhe si peng i pamundësive apo kufizimeve evropiane apo si produkt i investimeve dhe ndihmave financiare më të mëdha sesa të deritanishmet. Integrimi evropian ndodh kur shteti dhe shoqëria ndihen të tillë. Nuk duhet keqkuptuar "ndjesia", pasi shtetasit e Kosovës ndihen evropianë. Ndjesia për të cilën bëhet fjalë është ajo që e bën të ndihet evropian një shtetas të Italisë, Gjermanisë apo Suedisë, dhe ai është besimi që ata kanë tek shteti, jo domosdoshmërisht tek qeveria.

Ky besim duhet kuptuar si një bashkëjetesë e sinqertë dhe e ndershme e shtetit me qytetarin, në të gjitha aspektet. Në Kosovë një gjë e tillë nuk funksionon.

Shtetasit nuk bashkëjetojnë sinqerisht dhe ndershëmrisht me shtetin, ose më mirë nuk vendosen në kushtet për ta bërë një gjë të tillë. Sigurisht, pjesa më e madhe e përgjegjësisë u shkon organeve qeverisëse në të gjitha nivelet, pasi janë ato që kanë detyrimin dhe autoritetin që u buron nga sovranit, populli, për ta ndryshuar situatën. Ky është problemi thelbësor për integrimin evropian të Kosovës. Në sondazhet e kryera rezultojnë se shumica e qytetarëve në Kosovë mendon se proceset demokratizuese nuk shkojnë në drejtimin e duhur në vend. Kjo gjendje varet nga shumë faktorë:

Faktori i parë është ekonomia e dobët e Kosovës dhe varfëria e madhe. Rreth 50 % e popullsisë së Kosovës janë të pakënaqur nga pikëpamja ekonomike si dhe janë të gatshëm të protestojnë hapur për këtë situatë apo të largohen nga vendi. Kosova për nga raporti është shteti me popullsinë më të re në rajon dhe pjesa më e madhe e tij është e papunë.

Faktori i dytë është padrejtësia sociale. Sipas sondazheve, korrupsioni është një faktor madhor dhe me shumë ndikim në jetën publike. Korrupsioni lidhet edhe me një pjesë të papunësisë, sa 30 % e qytetarëve

mendojnë se punësimi mund të arrihet duke pasur një të afërm të pushtetshëm në aspektin publik, ose të jesh i angazhuar politikisht apo të paguash rryshfet për të ndërmarrë një sipërmarrje private, biznesi. Institucionet më të korruptuara shtetërore në Kosovë, sipas opinionin publik, konsiderohen pikërisht organet e qeverisjes qendrore ose në varësi të drejtpërdrejtë të saj. Këto të dhëna dëshmojnë paafësinë dhe mungesën e interesit të organeve shtetërore ndaj qytetarëve.

Faktori i tretë ka të bëjë me mungesën e sundimit të ligjit. Zbatimi i ligjit në Kosovë ndikohet nga kushtet që kanë shkelësit për ta anashkaluar dënimin. Korrupsioni në gjykata, ndërhyrja politike në proceset gjyqësore si dhe vonesat e mëdha në gjykimin e çështjeve nuk paraqesin një situatë pozitive në këtë aspekt. Për qytetarët kjo është dëshpëruese. Faktori i katërt ka të bëjë me situatën ndëretnike në Kosovë dhe menaxhimin e aspiratave të tyre. Situata në krainat veriore të Kosovës në aspektin e marrëdhënieve ndëretnike është shqetësuese. Mungesa e shtrirjes së autoritetit shtetëror, por edhe mungesa e një autoriteti domethënës në disa zona

veriore, qoftë të ndërkombëtarëve, qoftë të Serbisë, është diçka negative, që kontribuon më tepër në rritjen e pasigurisë sociale.

Të gjithë këta faktorë bien në kundërshtim me atë çka është BE-ja aktualisht. Autoriteti kryesor për menaxhimin e këtyre faktorëve është në radhë të parë shteti i Kosovës si dhe organet e tij, por është edhe vetë popullsia e saj. Analiza e këtyre faktorëve tregon se këta dy aktorë thelbësorë nuk bashkëpunojnë siç duhet dhe ky është problemi që ka ndikimin më të madh në procesin e integritit evropian të Kosovës. Integrimi në BE është objektiv i njëjti për këta dy aktorë, por bashkëveprimi është minimal. Nga ana e organeve shtetërore, sidomos atyre të Qeverisë së Kosovës, integrimi evropian interpretohet, ose më mirë të thuhet përkthehet, në përfundimin e marrëveshjeve të përvitshme për financime, deklaratave përkrahëse, liberalizimit të vizave, raporteve të progresit etj., pra kryesisht në aspektin burokratik të tij. Për qytetarët integrimi evropian qëndron tek vlerat, siguritë, ndjesitë, imazhet, pra shumë më i thjeshtë. Ata janë sot të vetmit qytetarë në Ballkan që nuk lëvizin drejt Evropës pa vizë.

Ndërrohet komanda e kontingjentit gjerman të KFOR-it

PRIZREN, 6 SHKURT (ER) - Në Kampin Fushor në Prizren, me një ceremoni festive, është bërë ndërrimi i komandës nga kontingjenti i 48 tek kontingjenti i 49 gjerman i KFOR-it. Në mesin e mysafirëve të shumtë të lartë, krahas ambasadorit gjerman në Kosovë, Christian Heldt, ishin edhe zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneralbrigade Janos Csombok, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (Director NALT), gjeneralbrigade Ralf Hoffmann, kryetari i Komunitetit të Prizrenit, Mytaher Haskuka, si dhe përfaqësues fetarë nga bashkësi të ndryshme fetare në Prizren dhe përfaqësues nga komunat.

Zëvendëskomandanti i Komandës për Udhëheqje të Misioneve të Bundeswehrit, gjeneralmajor Thorsten Poschwatta, ka dorëzuar komandën mbi kontingjentin gjerman të KFOR-it nga nënkolonel Hans Jurgen Elsen tek pasardhësi i tij, nënkolonel Christian Kiesel. Gjeneralmajor Poschwatta ka theksuar se Gjermania do të kontribuojë edhe më tutje për një Kosovë stabile.

Aktualisht në Kosovë në kuadër të misionit të KFOR-it veprojnë 400 ushtarë gjermanë të cilët e kanë për detyrë të ndihmojnë për ndërtimin e një mjedisi shumetnik, paqësor, ligjor dhe demokratik.



Recension

Kujtesa popullore për historinë e një lufte



Prof. dr. Nusret
PLLANA

Përkufizimi

Një vepër që shqyen kujtjtë e burimeve historike, dokumenteve arkivore dhe librave të historisë, ditarëve të atyre ngjarjeve dhe kronikave të kohës, vjen e shpalohep përmes gjurmëve të një kujtese, qoftë si pjesëmarrës i atyre ngjarjeve, qoftë si bashkëpunëtor i atyre personaliteteve, një pjesë e të cilëve kanë hyrë në histori. Një shkak më shumë, që mbështet një arsye madhore, jo vetëm për të folur për një luftë, për të cilën, siç thotë autori, ka

pasur shumë fjalë e pak fakte, ka pasur shumë spekulime, e pak njohuri, ka pasur shumë të dhëna të një anshme, pa u ndalur asnjëherë edhe te ato shtresime të kujtesës popullore. Doemos, kujtesa për ngjarje të caktuara ka peshën e saj, sidomos kur ajo është gjurmë e atyre që kanë qenë pjesëmarrës nëpër ato periudha kohore, kur janë zhvilluar ato ngjarje të mëdha të historisë sonë, në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Bedri Tahiri, ka sjellë një material interesant, me shumë të dhëna, të burimeve të ndryshme historike, me shumë informacion për Luftën e Drenicës.

Por, qasja e tij, kësaj radhe, nuk ka të bëjë as me ndonjë ngjarje të veçantë të kësaj lufte, as me ndonjë dukuri, që ka pasur nevojë të analizohet e të shqyrtohet, por as me mënyrën e

organizimit, as me rrjedhën e përgjithshme të Luftës së Drenicës.

Hyrje

Autori i veprës, Lufta e Drenicës, sipas rrëfimeve të Asllan Jasharit, në qasje të parë, që në titull ka dhënë idenë e strukturës së ndërtimit të veprës së tij, që mbështetet tërësisht në rrëfimet e një pjesëmarrësi në ato ngjarje të mëdha të historisë sonë. Mirëpo, kur lexohet vepra, kjo qasje del me një interes të veçantë historik. Autori nuk është ndalur në regjistrimin e të dhënave, sado që nuk mungojnë as burimet historike e trajtesat shkencore, por ato janë sistemuar në veprën e tij, si mbishtresime për të plotësuar saktësinë e rrëfimit, i cili, në radhë të parë, mbështetet në kujtesën e një atdhetari. Rrëfimtari i veprës së Bedri

Tahirit, nuk ishte vetëm pjesëmarrës i Luftës së Drenicës, por edhe i shumë ngjarjeve të tjera, para kësaj lufte dhe pas kësaj lufte, siç në të njëjtën kohë rrëfen edhe për ngjarjet e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për secilën nga ngjarjet që ka qenë temë e rrëfimit të këtij personazhi, autori ka sjellë edhe të dhëna të tjera, qoftë nga vepra të botuara për akëcilën prej ngjarjeve, qoftë burime arkivore, që janë publikuar, qoftë edhe shkrime nga revista dhe gazeta të ndryshme ku janë trajtuar disa nga ngjarjet, për të cilat sjellë kujtime regjintari i autorit, plaku atdhetar, Asllan Jashari.

Kjo qasje i ka dhënë dorë Bedri Tahirit, që në të njëjtën kohë të merret edhe me emra të veçantë të kësaj pjesë të historisë sonë, duke sjellë të dhëna jetësore dhe të dhëna për veprimtari atdhetare, për shumë nga figurat e

njohura historike të periudhave të ndryshme kohore.

Do të thotë, autori Bedri Tahiri, duke u marrë me rrëfimin e kujtimeve të një luftëtari të disa luftërave dhe të kohëve të ndryshme, në trevën e Drenicës, ka gjetur mënyrën e qasjes, që ato ngjarje, ata pjesëmarrës në ato ngjarje, ata prijës të atyre veprimtarive atdhetare, t'i sistemojë në strukturën e veprës së tij, jo vetëm si fakte jetësore, por edhe si të dhëna historike, qoftë për jetën e akëcilët pjesëmarrës, apo prijës, qoftë për bëmat e tyre, herë me peshë të madhe historike për rrjedhën e atyre ngjarjeve siç, fjala vjen, figura e Hasan Prishtinës, herë me peshë më të vogël, por doemos, shumë të rrëndësishme në ndërtimin e mozaikut të tërësisht së atyre ngjarjeve, për të cilat ka rrëfyer plaku i urtë, Asllan Jashari. (Vijon)

Themelohet Inspektorati i Trashëgimisë Kulturore të Kosovës

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka themeluar Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore. Ky organ inspektues i MKRS-së është përcaktuar sipas Ligjit për trashëgiminë dhe të martën është bërë konkretizimi i tij.

Me këtë rast, ministri Kujtim Gashi aktin zyrtar të konkretizimit të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore e ka vlerësuar përmbyllje të suksesshme të një politike të trashëgimisë pas një periudhe të gjatë të procedurave dhe pengesave të ndryshme administrative. "Për mua është një moment i veçantë e, pse jo, edhe moment krenarie që sot, përmes kësaj konference, po e bëjmë të njohur për publikun konstituimin e inspektoratit të trashëgimisë kulturore, detyrim ky ligjor i papërbushur për shumë vite. Në kuadër të përbushjes së detyrimeve ligjore që dalin si rezultat i legjislacionit në fuqi, rrjedhimisht Ligjit për trashëgimi kulturore, si dhe në kuadër të përbushjes së prioriteteve që kam vënë para vetes për vitin 2018, ku ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore përbëjnë një dimension të veçantë, kam marrë të gjitha



veprimet e duhura zyrtare dhe institucionale që të bëhet themelimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore", ka thënë ministri Gashi.

Inspektorati do të jetë një adresë edhe për ekspertët e trashëgimisë dhe krerët e institucioneve qendrore të trashëgimisë kulturore për ta realizuar kontrollin dhe paraqitur parregullsitë evidente. Gjithashtu, ky organ do të jetë një mekanizëm i cili do të shërbejë si instrument për parandalimin e dëmtimit të trashëgimisë kulturore. "Inspektorati është shumë i nevojshëm për fushën e trashëgimisë dhe, pavarësisht prej vonesave, do të jetë i mirëpritur për ekspertët dhe

institucionet e trashëgimisë në tërë territorin e Kosovës", u shpreh ministri Gashi, duke shtuar se ministria e ka funksionalizuar këtë organ edhe me kapacitete të nevojshme njerëzore dhe është në fazën e përfundimit edhe të infrastrukturës ligjore e fizike. "Zyrtarët përgjegjës që kanë marrë detyrën, kanë përgatitjen e duhur profesionale, integritetin moral dhe intelektual si dhe duke qenë i vetëdijshëm se këta zyrtarë shtetërorë kanë para vetes shumë punë, kërkoj prej tyre angazhim maksimal në detyrën që kanë marrë, që me guxim, besnikëri dhe syçeltësi të jenë gardianë të mbrojtjes së të kaluarës sonë", ka thënë Gashi.

Pula dhe vula

*Pula përpiqet për vetëm një letër
Sorollatet vërdallë korridorit bre,
Sa e vogël është, s'është me metër
Qe çmendur madje, goja ishte pa fre!*

*Një gërmë gabohet dhe ndryshon rendi
Ofshante ofiqari's dhe përmirësim kërkoi,
Certifikata tjetër dhe çfarë që sendi,
I ngrysur çdoherë dhe faqet fare fërkoj.*

*Nervozohej nëpunësi e po përgatitej pula
Prandaj pranë ishte e ai cilën citonte,
E pati n'xhep medet e verifikoi vet vula
Ndërhynje ndonjëherë e financat fitonte!*

*I mungonte more emrit vetëm njëra zanore
Tjetërsuhej tërë trajta dhe më mirë shtype,
Bereqeti bëhej mjaftuar dhe arave ranore
Ule kokën kodosh, prapë përmirësimin përtype.*

*Pikërisht pra ai atë kërkonte dhe doemos donte
Qëllimet qëndronin tek ai aty dhe mbetej prapa,
I ishin shtuar shpresat, andaj dhe me to rronte
I shtohet shija secilit, sepse dhe kërkon krapa!*

Anton F. GASHI
Janjevë, 2 gusht 2009

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON ZHIVETI
Adri Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

TOTTENHAM - NEWPORT COUNTY

GG3+

FC TWENTE - AZ

1

NAC - HERACLES

1

'Final 8' i Kupës, sivjet më i veçantë

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) dhe KB Golden Eagle Ylli kanë paralajmëruar se në Therandë nga 28 shkurti deri më 4 mars do të ketë spektakël basketbolli në kuadër të "Final 8" të Kupës së Kosovës. Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka thënë se sivjet "Final 8" i Kupës do të jetë më i veçantë

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) dhe KB Golden Eagle Ylli e kanë nënshkruar kontratën në të cilën përshkruhen në hollësi obligimet e organizatorit të "Final 8" që këtë vit është skuadra nga Theranda. "Final 8" i Kupës së Kosovës do të zhvillohet prej 28 shkurtit deri më 4 mars në palestrën "13 Qershori" në Therandë.

Kryetari i KB Golden Eagle Ylli, Naim Berisha, bëri me dije se skuadra e Yllit njihet për organizime të mira, kurse pret shikues në numër të madh në mënyrë që kjo ngjarje të bëhet më madhështore. "Klubi Golden Eagle Ylli ka dëshmuar në vitin 2015 se është i denjë për organizime të tilla, por me formatin e ri do të kemi më shumë obligime dhe përgjegjësi, por zotohemi se do t'i kryejmë të gjitha punët që dalin nga kontrata dhe udhëzuesi për organizimin e 'Final 8'. Presim shikuesit të jenë në numër sa më të madh dhe që gjithçka të frymojë në mënyrë sportive. Ne si organizator të bashkëpunim me FBK-në do të bëjmë përpjekje maksimale që kjo ngjarje të kalojë në mënyrë më të mirë të mundshme që KB Golden Eagle Ylli të mbahet mend për organizime të shkëlqyeshme", ka thënë ai.

E pranishme në nënshkrimin e marrëveshjes ishte edhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, e cila bëri me dije se FBK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për "Final 8" të Kupës së Kosovës, e cila është ndër ngjarjet më të rëndësishme për këtë vit. "Kupa e Kosovës për herë të parë do të organizojë me këtë format. Ne besojmë se Ylli do t'i kryejë të gjitha obligimet që i ka në bazë të kontratës dhe do të organizojë këtë ngjarje, e cila besojmë se do të jetë madhështore. Jemi të bindur se për këto katër ditë do ta kemi rastin të shohim basketbollin cilësor, i cili do t'i kënaqë të gjithë adhuruesit e basketbollit", ka thënë Dushku.

FBK-ja ka paraparë që më 28 shkurt të luhen dy ndeshje çerekfinale, Rahoveci-Kerasan Prishtina dhe Golden Eagle Ylli-



Borea, kurse më 1 mars zhvillohen dy takimet e tjera çerekfinale, Sigal Prishtina-Kalaja dhe Bashkimi-Trepça. Më 2 mars do të zhvillohen ndeshjet gjysmëfinale, kurse më 4 mars finale të të dyja konkurrencat. Ceremonia hapëse e "Final 8" të Kupës së Kosovës do të bëhet të mërkurën.

Më 4 mars mbahen Kuvendi i Punës së FBK-së dhe Klinika për Gjyqtarët

Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka bërë me dije se më 4 mars në Therandë do të mbahen Kuvendi i Punës së FBK-së dhe Klinika për Gjyqtarët Potencial për thirrje të FIBA-s. "Më 4 mars, në Therandë, do të mbahet Kuvendi i Punës i FBK-së dhe në kuadër të 'Final 8' të Kupës

së Kosovës prej 28 shkurtit deri më 3 mars do të organizohet nga FIBA Evropa dhe FBK-ja, Klinika për Gjyqtarët Kandidatë Potencialë për thirrje të FIBA-s. Klinika do të udhëhiqet nga drejtori i Departamentit të Gjyqtarëve në FIBA Evropë, Davorin Nakić (Kroaci), ndërsa do të ligjërojnë instruktorët e FIBA-s, Gjorgji Piperkov (Maqedoni) dhe Faton Kurshumlja (Kosovë)", ka deklaruar Dushku.

Pjesëmarrës të Klinikës pritet të janë 9 gjyqtarë potencialë, 4 nga Kosova dhe 5 të tjerë nga shtetet si Turqia, Greqia, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia. "Kjo është hera e tretë radhazi që FBK-së i behohet një organizim i tillë nga FIBA, pasi kjo e fundit është shumë e kënaqur me punën dhe organizimin në përgjithësi të bërë në dy vjetet e mëparshëm nga FBK-ja", ka shtuar Dushku.

SHKURT

De Biasi, afër Spalit

Trajneri Gianni de Biasi po diskuton me skuadrën modeste të Spalit. Ekipi që lufton për mbijetesën në kampionatin italian është i treti nga fundi në renditje dhe me vetëm 17 pikë të grumbulluara. Kandidatët për ta pasuar trajnerin Leonardo Semplici po diskutohen vetëm dy: Eduardo Reja dhe Gianni De Biasi, me këtë të fundit gjithmonë e më shumë në rritje.

KF Liria, mirënjohje për mbështetësit

KF Liria i ka falënderuar disa nga mbështetësit, duke u dhënë mirënjohje. Pa dyshim se mbështetësj kryesore e kësaj skuadre vazhdon të mbetet komuna. Kryesia KF Liria për arritjet dhe sukseset, krahas komunës, falënderon edhe Policinë e Kosovës, Shërbimin e Urgjencës, Kabinetin "Five Stars" si dhe subjektet e tjera që në cilëndo formë po e mbështesin klubin. Liria pret mbështetje edhe më të madhe në prag të stinorit pranveror nga të gjitha subjektet.

Kosova dhe Shqipëria, dy miqësore më 13 shkurt

Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) ka konfirmuar zhvillimin e dy miqësoreve të Kombëtares A, te femrat dhe meshkujt. Mysafirë të Kosovës do të jenë kombëtares respektive të Shqipërisë, që do ta madhështojnë këtë organizim, për nder të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Ndeshjet do të zhvillohen më 13 shkurt, nga ora 15:00 (femrat) dhe nga ora 17:00 (meshkujt). Këto takime do të zhvillohen në Pallatin e Sporteve "Shani Nushi" në Gjakovë dhe do të jetë hera e parë që ky qytet do t'i presë këto dy kombëtare në volejbol.

Komuna e Prishtinës cakton lokacionet potenciale për fusha

PRISHTINË, 6 SHKURT - Zyrtarë të Komunës së Prishtinës dhe përfaqësues të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) kanë parë nga afër pronat komunale ku potencialisht mund të ndërtohen dy fushat me bar sintetik.

Dy fushat ndihmëse që do të ndërtohen me financim të përfaqësues të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) pritet të përfundojnë

këtë vit. Pos dy fushave ndihmëse në Prishtinë, pritet të ndërtohen edhe dhjetë të njëjta nëpër komuna të tjera të Kosovës. "Këtë vit, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe Ministrinë e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të ndërtohen dy fusha sintetike të futbollit, me përmasa 105 x 68 metra, sipas standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s. Drejtori i pronës, Dren Kukaj, bashkë me përfaqësues të FFK-së, kanë dalë

në terren për t'i parë nga afër pronat komunale ku potencialisht mund të ndërtohen këto fusha, ashtu që të ndahen parcelat sa më të përshtatshme", thuhet në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Shkodra përforcon Liburnin

GJAKOVË, 6 SHKURT - Arbër Shkodra është përforcimi i radhës i Liburnit. Shkodra llogaritet si një nga talentet më të mira në Superligën e Francës, kurse së fundi ka mbrojtur

ngjyrat e Orchies Douai Futsal klub i cili bën gara në ligën elitare të Francës. Në këtë mënyrë Shkodra bëhet përforcimi i dytë për skuadrën gjakovare, pasi i pari ishte

Valdrin Qestaj. "Shkodra edhe më herët ishte pjesë e klubit tonë në sezonin 2015/2016, ku Liburni e humbi në fund titullin e kampionit. Me ardhjen e Shkodrës dhe lojtarëve në

dispozicion, Liburni qëllim kryesor e ka mbrojtjen e dy titujve: të Kupës së Kosovës dhe mbrojtjen e titullit të kampionit", thuhet në njoftimin e Liburnit.



Sërish përplasen Totti dhe Spalletti



ROMË, 6 SHKURT - Francesco Totti dhe Lucciano Spalletti, sërish protagonistë me sulmet ndaj njëri-tjetrit, të nisura që kur të dy ishin pjesë e Romës. Batuta ironike nuk mungojnë as tani që ish-kapiteni verdhëkuq është tërhequr nga futbolli, ndërsa trajneri ka ndërruar ambient, pasi aktualisht shërvehet Interin.

Trajneri zikaltër gjatë një komu-

nikimi me disa tifozë të Romës në lidhje me të shkuarën e tij të klubi kryeqytetas, ka shprehur konsideratën e tij për Tottin, e cila ka përfunduar në faqet e "Corriere della Sera": "Totti nuk vraponte më dhe të tjerët kur e shihnin të luante demoralizoheshin".

Një deklaratë private, tashmë e bërë publike, që sigurisht do të nxisë të tjera polemika. Në fakt,

legjenda e Romës, Totti, në një intervistë për mediet ruse, e dhënë para se të publikohet ky qëndrim i fundit i Spallettit, është shfaqur ironik me një fjali tepër të shkurtër për teknikun aktual të Interit, kur iu kërkua të përcaktonte me vetëm një fjali për ish-shokët dhe trajnerët e tij: "Nuk e njoh".

Dueli sapo është rindezur, topi vendoset sërish në qendër.

Clippersat mposhtin Dallasin në sekondat e fundit

LOS ANGELES, 6 SHKURT - Los Angeles Clippersi arriti një fitore në sekondat e fundit në ndeshjen ndaj Dallasit me shifrat 104-101, takim me rivalitet dhe emocione deri në fund, ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Shënuesi më i mirë për Clippersat ishte Gallinari me 28 pikë, mbështetur edhe nga Harris me 19, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e Matthewsit për Dallasin. Fiton edhe Orlando, që mposhti 111-109 Miamin në fushën e këtij të fundit, një tjetër ndeshje me rivalitet dhe emocione. Pjesa e parë ishte më e mirë për Miamin (i dallua Richardson me 20 pikë), por miqtë përmbyshën shifrat në pjesën e dytë falë 20 pikëve të Hezonja, raporton "Telesport". Sacramento fitoi 104-



98 ndaj Chicagos, tjetër takim që dhuroi emocione në fund, me vendësit që fituan në minutat e fundit pas një takimi të dominuar nga Bullsi. Gjashtë lojtarë të skuadrës së Sacramentos realizuan mbi 10 pikë, ndaj kolektiviteti ishte arma fituese e ekipit vendës po, për miqtë, nuk mjaftuan 27 pikët e LaVine, që mbetën

për statistikë. Fiton edhe ekipi i Denverit, që mundi 121-104 Charlotten, ndeshje e dominuar nga skuadra vendëse, që fitoi falë 27 pikëve të Harrisit. Pa probleme fitoi edhe Utah Jazzi që mposhti 133-109 New Orleansin në fushën e këtij të fundit, me miqtë që dominuan në sfidë falë 30 pikëve të Hoodit dhe 20 të Rubios.

SHKURT

Koeman, trajner i Holandës

Ronald Koeman është emëruar trajneri i ri i Kombëtares së Holandës. 54-vjeçari që prej shkarkimit nga Evertoni në tetorin e kaluar ishte i papunë, por tash ka nënshkruar një kontratë katër vjet e gjysmë me përfaqësuesen holandeze. Ai ka zëvendësuar Dick Advocaat, i cili u tërhoq nga posti i tij pasi dështoi të dërgonte "Tulipanët" në Kupën e Botës Rusi 2018. Koeman ka qenë trajner i Evertonit, Southamptonit, PSV-së, Valencias, Ajaxit, Viteses, Benficës, AZ dhe Feyenoordit.

Ebou: Pranoj të luaj edhe në Bagdad

Pas problemeve financiare dhe depresionit, ku ai shkoi derisa të mendonte vetëvrasjen pas braktisjes nga familja dhe humbjes së pasurisë, Emmanuel Eboue është gati t'i a nisë nga e para. Ish-mbrojtësi i Arsenalit thotë se mezi po pret të kthehet sërish në fushë pas ndihmës që i ofruan "topçinjtë", por edhe ish-klubi i Galatasarayt. "Gjithçka dua të bëj, është të luaj edhe një herë futboll. E kam ende aftësinë për të luajtur. Do të pranoja të shkoja edhe në vende si Bagdad apo Pakistani për të luajtur përsëri futboll. Nuk më intereson se ku. Unë jetoj me vëllezët gati dhe nga momenti në moment mund të më nxjerrin nga shtëpia. Nuk kam asnjë pranë në këto momente. Ndihej i braktisur. Dikur shkoja mirë me fëmijët dhe familjen, por sot jam krejtësisht i vetëm", ka thënë 34-vjeçari për "Canal", i cili ka mbetur i pastrehë, edhe pse dikur luante në finalen e Ligës së Kampionëve përballë Lionel Messit (2006).

Messi e dëshiron Alaban në "Camp Nou"

Lionel Messi ua ka dorëzuar drejtuesve të Barcelonës një listë të ngushtë me tre lojtarë të cilët ai dëshiron t'i shohë në "Camp Nou" gjatë verës, raporton "Don Balon". Në mesin e tyre raportohet të jetë edhe mbrojtësi i Bayern Munchenit, David Alaba. Emrat e tjerë në listën e dëshirave të Messit thuhet të jenë Marcos Alonso i Chelsea dhe Jose Gaya i Valencias.

Shkarkimi nuk e shqetëson Conten

Skuadra e Chelsea pësoi humbje të thellë nga Watfordi (4-1), por trajneri Antonio Conte nuk është aspak i shqetësuar lidhur me shkarkimin e tij. "Nuk jam i shqetësuar. Unë punoj çdo ditë dhe jap 12-përqindëshin tim dhe nëse kjo është e mjaftueshme, atëherë në rregull. Përndryshe, klubi mund të marrë ndonjë vendim tjetër. Është shumë e vështirë sepse çdo ditë dhe në çdo konferencë ju më pyesni nëse jam i shqetësuar. Jo, nuk jam i shqetësuar", ka thënë Conte.

Rooney: Kane mund të transferohet në Real

Sulmuesi i Anglisë, Wayne Rooney beson, se sulmuesi i Tottenham Hotspurit, Harry Kane, do të largohet nga klubi pas përfundimit të këtij sezoni. Ylli i Evertonit mendon se bashkëkombësi i tij do ta kërkojë transferimin te një klub më i madh, pas interesimit nga Real Madridi. "Për momentin, ai është mbase sulmuesi më i mirë në Evropë. Problemi që Tottenhami do ta ketë është se motiv i tij janë golat, ama motivimi i tij do të ndryshojë nga gola në trofe. Dhe nëse Tottenhami nuk fiton trofe vitin e ardhshëm apo në dy vjetët e ardhshëm, atëherë ai do të kërkojë të fitoj trofe diku tjetër", ka thënë Rooney për "Sky Sports".

Enrique pritet të jetë pasardhës i Contes

Forma jo e mirë e Chelsea të këtë edicion dhe dy humbjet e fundit kanë bërë që e ardhmja e Antonio Contes në krye të kësaj skuadre të vihet në rrezik. Në rast të shkarkimit të trajnerit në krye të Chelsea pritet të emërohet ish-trajneri i Romës dhe Barcelonës, Luis Enrique. Lajmin e ka bërë me dije katalanasja "Sport". Aktualisht skuadra e Chelsea zë vendin e katërt në Premierë Ligë me 50 pikë të grumbulluara.

REZULTATET

Detroit - Portland	111-91
Indiana - Washington	102-111
Miami - Orlando	109-111
New Orleans - Utah Jazz	109-133
Denver - Charlotte	121-104
Sacramento - Chicago	104-98
Clippers - Dallas	104-101



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë* bën:

Shpallje të konkursit për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: **Arsimit të lartë**

Paga bruto: **423.47 €**

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e për informim akademik dhe barasvlerë të kualifikimeve në arsim të lartë (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 06.02.2018

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Harton dhe zhvillon planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Analizon legjislacionin, politikën dhe procedurat në lëmin e njohjes dhe barasvlerës së arsimimit të lartë dhe rekomandon përmirësimin e proceseve nëse është e nevojshme;
- Harton dhe zhvillon legjislacionin, politikën, programet, procedurat dhe dokumentet tjera për njohje dhe barasvlerë të kualifikimeve në arsimin e lartë
- Zhvillon dhe siguron zbatimin e masave dhe aktiviteteve me qëllim të avancimit të punës, procesit të vendosjes dhe aplikimit të procedurave dhe standardeve lidhur me proceset e njohjes dhe barasvlerës së kualifikimeve në arsim e lartë;
- Bashkëpunon me qendrat tjera dhe institucionet e arsimit të lartë dhe siguron informata në lidhje me njohjen dhe hyrjen në nivelin kombëtar të kualifikimit;
- Siguron informata për institucionet dhe qytetarët për drejtat lidhur me njohjen dhe sistemet evropiane të shkollimit dhe këshillin në lidhje me njohjen e kualifikimeve;
- Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit, politikave, procedurave dhe dokumenteve tjera lidhur me njohjen dhe barasvlerën e arsimimit të lartë si dhe këshillin mbikëqyrës të sektorit tjerë të arsimit për procesin e për njohjes dhe barasvlerës së kualifikimeve në arsimin e lartë;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet

- Diplomë universitare, 3 vite përvojë pune.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloret të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internetit).

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi të fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 6 ditë kalendare nga dita e publikimit në ueb faqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit **12.02.2018.**

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në ueb faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 1, në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije:*

Objavljuje konkurs za "Sporazum o posebnim uslugama "

Institucija: *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

Departament: **Visoko obrazovanje**

Bruto plata: **423.47 €**

Naziv radnog mesta: Službenik/ca za akademskog informisanja i ekvivalenciju kvalifikacija visokog obrazovanja (1 radno mesto)

Trajanje ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Datum:** 06.02.2018

Zadaci i odgovornosti:

- Sastavlja i razvija radne planove sa pretpostavljenim u skladu sprovođenjem zadataka utvrđenih na osnovu objektivna jedinice i daje preporuke u vezi realizacije ovih objektivna;
 - Analizira zakonodavstvo, politiku i procedure u oblasti priznavanje i ekvivalenciju visokog obrazovanja i preporučuje poboljšavanje procesa ako je to potrebno;
 - Sastavlja i razvija zakonodavstvo, politiku, programe, procedure i ostala dokumenta o priznavanju i ekvivalenciji kvalifikacija u visokom obrazovanju
 - Razvija i obezbeđuje primenu mera i aktivnosti u cilju unapređenje posla, procesa uspostavljanje i primeni procedura i standarda vezano za procese priznavanja i ekvivalenciji kvalifikacija u visokom obrazovanju;
 - Saraduje sa drugim centrima i institucijama visokog obrazovanja i obezbeđuje informacije u vezi priznavanja i uključivanje na nacionalnom nivou kvalifikacije;
 - Obezbeđuje informacije za institucije i građane o pravima u vezi priznavanje i evropskih sistema školovanja i savetuje u vezi priznavanje kvalifikacije;
 - Nadzire primenu zakonodavstva, politike, procedure i ostala dokumenta u vezi priznavanje i ekvivalenciju visokog obrazovanja kao i savetuje pretpostavljene drugih sektora u obrazovanje u vezi procesa priznavanja i ekvivalencije kvalifikacija u visokom obrazovanju;
 - Vrši i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima koje može opravdano povremeno da zatraži pretpostavljeni;
- Kvalifikacije**

- Univerzitetnu diplomu, 3 godine radnog iskustva.
- Znanje i iskustvo u oblast obrazovanja
- Poznavanje važećih zakona i propisa koji se odnose na obrazovanje
- Veštine u komunikaciji planiranje poslova i rukovođenje ekipe it;
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
- Veštine u ispunjavanju zadataka i poslova pod pritiskom;
- Kompjuterske veštine aplikacije programa (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internet).

Uslovi učešće na konkursu:

Pravo na aplikaciju imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost delovanja, potrebni nivo obrazovanja i profesionalne veštine za obavljanje zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Datum zatvaranje konkursa: Konkurs ostaje otvoren 6 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnom novinama. Datum zatvaranje konkursa j **12.02.2018.**

Kandidati aplikacije (formular za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/>, ili da podignu u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: UL "Agim Ramadani" br. 1, u kancelariji arhive u kojoj će i dostaviti popunjene aplikacije.

Uz aplikaciju treba priložiti: Kopiju lične karte, kopiju dokumenta o kvalifikaciju, kao i druga dokumenta koja se zahtevaju konkursom .
Zahtevi poslani nakon isteka datuma neće se primati. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktirani će biti samo kandidati koji budu izabrani na uzoj listi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë* bën:

Shpallje të konkursit për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Arsimit të lartë
Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e administrativ për njohje dhe barasvlerë të kualifikimeve në arsim të lartë (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Date:** 06.02.2018

Detyrat dhe përgjegjësit:

1. Punë me palë;
2. Arkivon dhe sistemon dosjet që përfundojnë procedurën për nostrifikim
3. Informon palët për tërheqje të vendimeve
4. Mban procesverbal dhe përgatiti procesverbalin e KSHNJ
5. Si dhe punë të tjera sipas nevojës së Qendres NARIC

Kualifikimet

1. Diplomë universitare, 2 vite përvojë
2. Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit
3. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
4. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
5. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
6. Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
7. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internet).

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 6 ditë kalendare nga dita e publikimit në ueb faqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 12.02.2018.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në ueb faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 1, në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*:

Objavljuje konkurs za "Sporazum o posebnim uslugama"

Institucija: *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

Departament: Visoko obrazovanje
Bruto plata: 423.47 €

Naziv radnog mesta: Administrativni/a službenik/ca za priznanje i ekvivalenciju kvalifikacija u visoko obrazovanje (1 radno mesto)

Trajanje ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Datum:** 06.02.2018

Zadaci i odgovornosti:

1. Rad sa strankama;
2. Arhivira i sistematizuje dosije koji su završile proceduru nostrifikacije
3. Obaveštava stranke o povlačenju odluke
4. Vodi zapisnik i priprema zapisnik DSP
5. Kao i druge poslove shodno potrebama Centra NARIC

Kvalifikacije

1. Univerzitetsku diplomu, 2 godine radnog iskustva
2. Znanje i iskustvo u oblast obrazovanja
3. Poznavanje važećih zakona i propisa koji se odnose na obrazovanje
4. Veštine u komunikaciji planiranje poslova i rukovođenje ekipe;
5. Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
6. Veštine u ispunjavanju zadataka i poslova pod pritiskom;
7. Kompjuterske veštine aplikacije programa (Word, Excel, PowerPoint, Access, Internet).

Uslovi učesće na konkursu:

Pravo na aplikaciju imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost delovanja, potrebni nivo obrazovanja i profesionalne veštine za obavljanje zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Datum zatvaranje konkursa: Konkurs ostaje otvoren 6 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnim novinama. Datum zatvaranje konkursa je 12.02.2018.

Kandidati aplikacije (formular za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/>, ili da podignu u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije. Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, u kancelariji arhive u kojoj će i dostaviti popunjene aplikacije.

Uz aplikaciju treba priložiti: Kopiju lične karte, kopiju dokumenta o kvalifikaciju, kao i druga dokumenta koja se zahtevaju konkursom .

Zahtevi poslati nakon isteka datuma neće se primati. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktirani će biti samo kandidati koji budu izabrani na užoj listi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë* bën:

Shpallje të konkursit për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Arsimit të lartë
Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e për njohje dhe barasvlerë të kualifikimeve në arsim të lartë
(1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 06.02.2018

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Hartoni dhe zhvilloni planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Merr pjesë në hartimin e legjislacionin, politikat, procedurat, programet, për tjerë për njohje dhe barasvlerë të kualifikimeve në arsimin e lartë;
- Merr pjesë në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të miratuara me qëllim të avancimit të punës, procesit të vendosjes dhe aplikimit të procedurave dhe standardeve lidhur me proceset e njohjes dhe barasvlerës së kualifikimeve në arsimin e lartë;
- Bashkëpunoni me qendrat tjera dhe institucionet e arsimit të lartë dhe siguron informata në lidhje me njohjen dhe hyrjen në nivelin kombëtar të kualifikimit;
- Zhvilloni dhe siguron procesin e verifikimit të dokumentacionit të arsimit të lartë privat dhe ndihmoni në përgatitjen e dokumenteve dhe aktiviteteve të nevojshëm lidhur me procesin e njohjes dhe barasvlerës të kualifikimeve në arsimin e lartë
- Përgatit të gjitha materialet e nevojshme për takimet e bordit për procesin e njohjes dhe barasvlerës së kualifikimeve në arsimin e lartë;
- Përgatit raporte periodike dhe informatave tjera për procesin e njohjes dhe barasvlerës së kualifikimeve në arsimin e lartë dhe punën e divizionit ;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrsi;

Kualifikimet

- Diplomë universitare, 2 vite përvojë pune.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloret të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbashkëpunim të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi të fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 6 ditë kalendare nga dita e publikimit në ueb faqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 12.02.2018.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në ueb faqen e MASHT-it <http://mashtrks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 1, në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

U shtetë me odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*:

Objavljuje konkurs za "Sporazum o posebnim uslugama "

Institucija: *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

Departament: Visoko obrazovanje
Bruto plata: 423.47 €

Naziv radnog mesta: Službenik/ca za priznavanje i ekvivalenciju kvalifikacija u visoko obrazovanje
(1 radno mesto)

Trajanje ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Datum:** 06.02.2018

Zadaci i odgovornosti:

